



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
-AUTORITETI I KONKURENCËS-

**NJOFTIM PARAPRAK PËRQËNDRIMI**

**(Rasti Antea Cement ShA— Alba Cement Italia Shpk)**

Në datën 06 Shkurt 2008, Autoriteti i Konkurrencës ka marrë njoftimin e përqendrimit të propozuar në përputhje me nenin 10, pika 1, shkronja b të Ligjit Nr.9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, sipas së cilit shoqëria Antea Cement ShA me seli në Tiranë, Shqipëri, përfiton kontroll nëpërmjet blerjes të pjesës prej 65% të kapitalit aksionar të shoqërisë Alba cement Shpk, me seli në Tiranë, Shqipëri.

Ky transaksion, sipas marrëveshjes së shitjes së aksioneve nënshkruar nga palët pjesëmarrëse është kryer në datën 1 Shkurt 2008.

1. Veprimtaria e palëve pjesëmarrëse është:

- **Shoqëria Antea Cement Sh.a**, është themeluar në vitin 2006 dhe funksionon sipas legjislacionit shqiptar. Objekti i veprimtarisë së saj është ndërtimi i një fabrike për prodhimin e çimentos për vend dhe import në zonën e Krujës. Shoqëria Antea Cement Sh.a zotërohet 100% në mënyrë të tërthortë, nëpërmjet shoqërisë Alvacim Limited, (me veprimtari financiare, me qendër në Nicosia, Qipro) nga Titan group. Titan Group ka nën kontroll mbi 40 shoqëri që veprojnë në Greqi, Qipro, Bullgari, Serbi, Maqedoni, Itali, Angli, Egjipt, Shqipëri, Kosovë , Mal i Zi etj. , për: Materiale ndërtimi (lloje të ndryshme çimento, laç, beton).

Në tregun shqiptar, Titan group është i pranishëm me produktet e tij nëpërmjet filialit grek “Albacem Cement, Beton dhe Gurore Sha)

- **Shoqëria Alba Cemento Italia Shpk**, është themeluar në vitin 2000 dhe funksionon sipas legjislacionit shqiptar. Objekti i veprimtarisë është importimi dhe tregtimi i produktit çimento dhe nënprodukteve të tij, të ambalazuara dhe rifuxhio. Është përfaqësuesi ekskluziv i grupit “Buzzi Unicem”, me qendër në Barletta, Itali.

Shoqëria Alba Cemento Italia nuk ka veprimtari në tregun e prodhimit të çimentos në Shqipëri.

Ortakët e shoqërisë Alba Cemento Italia Shpk, kontrollojnë shoqëri të tjera, që veprojnë në tregun me shumicë të tregtimit të produkteve elektrike, përfshirë këtu tregtimin dhe instalimin e dhe të paisjeve për ngrohje e ftohje.

2. Nga shqyrtimi paraprak, Autoriteti gjeti, që transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të Ligjit dhe do t'i nënshtrohet procedurës së kontrollit të përqendrimeve të përcaktuar në nenin 56 të Ligjit dhe në Rregulloren “Për Zbatimin e procedurave të Përqendrimit të Ndërmarrjeve”.

Autoriteti i Konkurrencës fton palët e treta për të shprehur opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

Opinionet duhet të paraqiten jo më vonë se 15 ditë nga publikimi i këtij njoftimi në adresat: Autoriteti i Konkurrencës, me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr “Sami Frashëri”, Nr 4 Tiranë; fax (nr 0355 4 234 497), e-mail në adresën [competition@caa.go.al](mailto:competition@caa.go.al).